



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 23 korrik 2012
Nr. Ref.: RK 286/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI63/11

Parashtruesi

Veli Kuqi

**Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së aktgjyimit të Gjykatës Supreme të Kosovës
A. Br. 1239/2010 të 23 marsit 2011**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Ivan Čukalović, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i Kërkesës është Veli Kuqi nga fshati Shirokë, Komuna Suharekës.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës A. Nr. 1239/2010 të 23 marsit 2011 me të cilën refuzohet padia e parashtruesit të kërkesës për dëmshpërblimin e dëmit material dhe jomaterial, mbi kontestin kundër Ministrisë së Punës dhe Mbrojtjes Sociale (në tekstin e mëtejme: MPMS) Departamenti i Administratës Qendrore (në tekstin e mëtejme: DAQ) për ndërprerjen e pensionit

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës sfidon Gjykatën Supreme të Kosovës A. Nr. 1239/2010 të 23 marsit 2011 duke konsideruar se i është shkelur e drejta për pensionim të parakohshëm të pleqërisë të fituar në bazë të punës dhe pensionit invalidor të paraparë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Baza juridike

4. Kërkesa parashtrohet në bazë të neneve 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, neneve 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr.03/L-121 mbi Gjykatën Kushtetuese të Kosovës të 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejme: „Ligji“) dhe Rregullit 56 par. 2 i Rregullores së punës.

Procedura para Gjykatës

5. Parashtruesi i Kërkesës më datën 11 maj 2011 ka parashtruar kërkesë para Gjykatës kushtetuese të republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: „Gjykata“)
6. Më 20 qershor 2011 Gjykata Kushtetuese ka njoftuar Gjykatën Supreme të Kosovës se është nisur procedura e vlerësimit të kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës A. Nr. 1239/2010 të 23 marsit 2011.
7. Me vendimin e Kryetarit (Nr. GJR.63/11 të 17 gushtit 2011), gjyqtarja Gjyljeta Mushkolaj emërohet për gjyqtare raportuese. Po të njëjtën ditë, me vendimin e kryetarit Nr. KSH.63/11 emërohet Kolegji shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Prof. Dr. Iliriana Islami.
8. Me vendimin e kryetarit (Nr. GJR.117/11 dhe Nr. KSH/63/11 të 2 korrikut 2012), gjyqtari Ivan Čukalović u emërua si Gjyqtar raportues në vend të gjyqtarës Gjyljeta Mushkolaj, ndërsa gjyqtari Altay Suroy si anëtar i Kolegjit Shqyrtues në vend të gjyqtarës Iliriana Islami, të cilave më 26 qershor 2012 u përfundoi mandati si gjyqtare të Gjykatës Kushtetuese.
9. Më 11 korrik 2012, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit Ivan Čukalović, Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Altay Suroy, i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës

Përmbledhja e fakteve

10. Më 9 shtator 1973 parashtruesi i kërkesës ka lidhur marrëdhënie pune në Sekretariatit Krahinor të Punëve të Brendshme (në tekstin e mëtejme: SKPB).
11. Parashtruesi i Kërkesës ka punuar në disa vende të punës në SKPB si zyrtar i autorizuar, ndërsa me rastin e kryerjes së detyrës zyrtare në SKPB më 1 prill 1981 parashtruesi i kërkesës është plagosur gjatë kohës së protestave në rrugë (demonstratave).

12. Më 9 qershor 1989 me shkresën nr. 04-118-36 parashtruesi i kërkesës ka kërkuar nga SKPB t'i lejohet dalja në pension të parakohshëm të pleqërisë, në të cilën në esencë konsideron *„...se për shkak të plagosjes së vitit 1981 është shpallur invalid ushtarak paqësor me 40% të dëmtimit të shëndetit trupor,...*“
13. Më 25 shtator 1989 me vendimin nr 7004035303 në bazë të ligjit të atëhershëm në fuqi parashtruesit të kërkesës i është pranuar e drejta për pension të parakohshëm të pleqërisë. Pensionin e parakohshëm të pleqërisë parashtruesi i kërkesës e ka gëzuar deri në vitin 1989 kur qeveria e Serbisë ka ndaluar së paguari pensionet e personave me nacionalitet shqiptar.

Procedura për kërkesën e pensionit për persona me aftësi të kufizuara

14. Më 31 maj 2010 parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kërkesë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejshëm: MPMS), Departamentit të Administratës së Pensioneve të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: DAPRK) që t'i pranohet e drejta për pension të parakohshëm për persona me aftësi të kufizuara.
15. Më 10 shkurt 2011 me vendimin e DAPRK, e në bazë të vendimit që ka përvetësuar këshilli për padi nr. 5097090 të 10 dhjetorit 2010, parashtruesit të kërkesës i është pranuar e drejta e pensionit për persona me aftësi të kufizuara.

Procedura për kërkesën për pension të parakohshëm të pleqërisë dhe pension invalidor

16. Megjithatë, në ndërkohë më 5 korrik 2010 parashtruesi i kërkesës i drejtohet MPMS me kërkesë të re në të cilën kërkon që përsëri t'i aktivizohet pensioni i parakohshëm i pleqërisë që kishte fituar dhe pensioni invalidor që kishte gëzuar para se të fillonte konflikti luftarak në Kosovë.
17. Më 21 korrik 2010 në përgjigjen e MPMS-DAPRKnr. 4920 për kërkesën e re në të cilën në esencë pohohet si në vijim;

„...se pensionin që ka gëzuar para luftës, nuk mund t'a gëzojë, për arsye se për pensionin në bazë të punës nevojitet të përmbushet kushti i pleqërisë 65 vjeçare. Që problemi i pensioneve të mbetura nuk është vetëm juaji, por është një problem i cili ekziston për rreth 50,000 penzionerë në Kosovë, të cilët kanë qenë penzionerë të fondit të ish Federatës Jugosllave, ose të atyre që kanë punuar në ndërmarrjet e Serbisë...“

„...Që në bazë të listës së çështjeve që ka paraqitur ekziston alternativa në pikëpamje të pensioneve për persona me aftësi të kufizuara ose në pikëpamje të ndihmës sociale... dhe “(pensioni për persona me aftësi të kufizuara i cili i është aprovuar parashtruesit të kërkesës më 10 shkurt 2011 me vendimin e DAPRK dhe në bazë të vendimit që ka përvetësuar këshilli për padi nr. 5097090 të 10 dhjetorit 2010)”.

18. Në përgjigjen nr. 4920 të MPMS-DAPRK të 21 korrikut 2010 parashtruesi i kërkesës parashtron padi para Gjykatës Supreme të Kosovës më 22 dhjetor 2010 në të cilën kërkon kompensimin e dëmit nga MPMS për ndërprerjen e pagesës së pensionit të parakohshëm të pleqërisë dhe pensionit invalidor në kohëzgjatje prej 11 vjetësh.
19. Më 23 mars 2011 Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin A. Br. 1239/2010 refuzon padinë si të pabazë ku ndër të tjera pohohet si në vijim;

„Gjykata Supreme e Kosovës ka konstatuar se padia është e pa bazuar, sepse ka vlerësuar, se organi i paditur, aktvendimi i te cilit kontestohet nuk është trashëgimtare e fondeve të ndryshme të pensioneve nga sistemi i shtetit të shpërberë të ish Jugosllavisë. Sipas rregullores 2001135, Administrata pensionale është themeluar në kuadër të MPMS-se, dhe është e obliguar t'i rregullon pagesat e pensioneve bazë të personave që i plotësojnë kriteret sipas kësaj rregulloreje

Skema e bazës së pensioneve në Kosovë pas luftës, ka filluar më 1 korrik 2002, në kuadër të DAPRK, e cila rregullon pensionet e kontribut-dhënësve me stazh të sigurimit personal) sipas Rregullores Administrative nr.11/2007. Bazuar në gjendjen faktike, rezulton se institucionet e Republikës së Kosovës janë autoritete të reja të qeverisë, të cilat njëkohësisht nuk janë trashëgimtarë ligjor të organeve të qeverisë para vitit 1999.“

Pretendimet e parashtruesit

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës A.Nr. 1239/2010 të 23 marsit 2010 janë shkelur të drejtat për pensionim të parakohshëm të pleqërisë dhe pensionim invalidor duke theksuar se ka ardhur deri të shkelja e nenit 102 të Kushtetutës pika 3i cili parashih „Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe Ligjit.“
21. Në fund parashtruesi i kërkesës pretendon se është shkelur edhe neni 22 i Kushtetutës i cili parashih zbatimin direkt të marrëveshjes dhe instrumenteve ndërkombëtare, e konkretisht edhe kartën sociale Evropiane të vitit 1996.
22. Parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës si vijon:

“Përmes parashtrimit të kësaj kërkesë dëshirojë të arrijë që të vërtetohet se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës A nr.1239 dt. 22.12.2010 është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës dhe me të cilin aktgjykim më është shkelur e drejta ime për të qenë shfrytëzues i pensionit invalidor të punës. Pra, unë jam privuar nga e drejta për të marrë pensionin invalidor të punës pasi që edhe i plotësoj të gjitha kushtet për një pension të tillë. Për shkak të aftësisë sime të kufizua unë jam i detyruar ta braktisë punën që e kam ushtruar për disa vite. Dhe për atë shkak që jam i paaftë edhe kam aplikuar për pension invalidor të punës. Për shkak të këtij aktgjykimi ende po vuaj nga mos realizimi i të drejtës sime.”

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

23. Parashtruesi i kërkesës thekson se neni 22 (Zbatimi Direkt i Marrëveshjes dhe Instrumenteve Ndërkombëtare) dhe neni 102 (Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor) paragrafi 3 i Kushtetutës së Kosovës, janë bazë për kërkesën e tij
24. Neni 48 i ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës parashih:

„Parashtruesi i kërkesës është i detyruar që qartazi të potencojë se cilat të drejta dhe liri i janë shkelur dhe cili është akti konkret i autoriteteve publike që parashtruesi dëshiron të sfidojë.“
25. Sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e apelit, në rastet kur shqyrtohen rastet e sjella nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është që të interpretojnë ligjin dhe zbatimin e rregullave të përshtatshme të procedurave dhe të drejtës materiale (shih *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [GC], br. 30544/96, paragrafi 28 Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut [GjEDNj],1999-I).

26. Parashtruesi i kërkesës nuk ka sjellë ndonjë dëshmi *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese (shih, Vanek kundër Republikës Sllovaqe, Vendimi i GJEDNj në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99 të 31 majit 2005). Parashtruesi i kërkesës nuk thekson se në çfarë mënyre e mbështetin kërkesën e tij neni 22 dhe 102, ashtu siç parashihet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me nenin 48 të Ligjit.
27. Parashtruesi i kërkesës pohon se të drejtat e tij janë shkelur me përcaktimin e gabuar të fakteve dhe me zbatimin e gabuar të ligjit nga ana e gjykatave të rregullta, duke mos theksuar qartë se si ato vendime kanë shkelur të drejtat e tij kushtetuese.
28. Në këtë rast parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi të shumta që të paraqesë rastin e tij para Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe para Gjykatës Supreme, dhe të kontestojë interpretimin e ligjit që mendonte se ishte i gabuar. Pas shqyrtimit të kërkesës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk gjen që procedurat përkatëse ishin të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNj-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës nr.17064/06 të 30 qershorit 2009).
29. Nga kjo del se kërkesa është e pabazuar në pajtim me Rregullin 36 (2b) të Rregullores së Punës që parasheh se „Gjykata hedh poshtë kërkesën qartazi si të pabazë kur përfundohet se b) faktet e nxjerra në asnjë mënyrë nuk arsyetojnë pretendimet dhe shkeljen e të drejtave kushtetuese,“.

PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 11 korrik 2012, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues

Ivan Čukalović



Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani